# RAPORTI
# I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK
# PËR PROGRAMIN E STUDIMIT BACHELOR NË FIZIOTERAPI

## OFRUAR NGA UNIRESITETI ALDENT


Ekspertët e vlerësimit të jashtëm:

**PROF. DR. DHIMITRAQ STRATOBËRDHA**

**PHD. MIGENA KIKA**


(Qershor/2018)

# RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

## Për Programin e studimit Bachelor në Fizioterapi.

| | Tabela e të dhënave për programin e studimit | |
|---|---|---|
| 1 | IAL Aplikues: | Universiteti "Aldent" |
| 2 | Fakulteti që e ofron | Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike |
| 3 | Urdhëri/VKM i licencimit | Urdhër Nr.370, datë 27.07.2011 |
| 4 | Urdhëri/VKA e Akreditimit të parë | Urdhër Nr. 326, datë 27.08.2012 |
| 5 | Titulli i programit të studimit: | Bachelor në "Fizioterapi" |
| 6 | Cikli i studimit: | I parë |
| 7 | Kohëzgjatja e programit të studimit: | 3 vite akademike |
| 8 | Kreditet në total (ECTS): | 180 ECTS |
| 9 | Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/): | Me kohë të plotë |
| 10 | Gjuha (shqip/tjetër): | Shqip |
| 11 | Programi ofrohet nga institucioni | Po |
| 12 | Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera | Jo |
| 13 | Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin): | Jo |
| 14 | Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin): | Jo |
| 15 | Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve | 6 |
| 16 | Nr i studentëve<br>2015-2016<br>2016-2017<br>2017-2018 | 102 studentë<br>60 studentë<br>60 studentë |

**HYRJE**

**Të dhëna për programin e studimit Bachelor në Fizioterapi.**
**Raporti i Vlerësimit të Jashtëm i hartuar nga Ekspertët e vlerësimit, bazohet në të dhënat e sjella nga Institucioni në Raportin e Vlerësimit të brendshëm, anekseve përkatëse të këtij Raporti, vizitës dy ditore të zhvilluar në Institucion më datë 24 dhe 25 Prill 2018. Gjatë vizitës në institucion, Grupi i Vlerësimit të jashtëm kërkoi dokumentacion plotësues për disa sqarime për rubrika të veçanta të RVB. Ky dokumentacion u ngarkua në sistemin AMS nga koordinatorja e Institucionit. Materialet u hodhën në hapin përkatës nga koorinatorja teknike e ASCAL.**

Universiteti Aldent **(UAL)** është një institucion privat i arsimit të lartë i liçensuar me vendim të Këshillit të Ministrave, Nr. 673, datë 27.9.2006. Ky institucion ofron 9 programe studimi në tre cikle studimi .
Universiteti “Aldent” e ka nisur veprimtarinë e tij akademike si institucion arsimor në vitin 2003, ku u liçensua si një shkollë profesionale për programin e studimit “Laborant Dentar” – cikël 2 vjecar.
Në vitin 2006 me VKM nr.673, dt.27.09.2006 u liçensua si shkollë e Lartë Universitare “Aldent”. Në dt.13/06/2013, me VKM nr.539, UAL fiton Statusin Universitet dhe në mars të vitit 2016 u riakreditua insitucionalisht nga APAAL me ekspertë ndërkombëtar dhe vlefshmëria e këtij akreditimi është deri në 2022. Në vijim të akreditimeve që institucionet e arsimit të lartë shqiptar bën me Agjensinë britanike të Akreditimit QAA, Universiteti Aldent megjithëse ishte brenda një akreditimi të vlefshëm, me kërkesën e vet mori pjesë përsëri në këtë akreditim. Në përfundim të tij ai u vlerësua me riakreditim me vlefshmëri përsëri deri në vitin 2022.
Universiteti është themeluar dhe drejtohet nga mjekë dhe pedagogë me experience të gjatë në mësimdhënie.
Gjatë këtyre viteve, UAL ka pësuar ndryshime të rëndësishme duke u rritur hap hapi por në mënyrë të qëndrueshme. Universiteti “Aldent” përbëhet nga tre fakultete:
- Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike
- Fakulteti i Shkencave Dentare
- Fakulteti i Shkencave Mjekësore

Programi Bachelor në “Fizioterapi” Pas licensimit, me urdhër Nr.370, datë 27.07.2011 programi i studimit të ciklit të parë në “Fizioterapi” (Bachelor-3 vite akademike) kaloi me sukses akreditimin e parë me urdhër Nr. 326, datë 27.08.2012, për “Akreditimin e programit të studimit të ciklit të pare Bachelor në “Fizioterapi”, të shkollës së lartë universitare jopublike ALDENT” dhe tashmë ka plot 6 vjet nga ky proces.

**GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)**
Përbërja e GVJ: Bordi i Akteditimit dhe Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, vendosën: PhD Migena Kika dhe Prof. Dr. Dhimitraq Stratobërdha ekspertë të jashtëm vlerësimi për këtë program studimi.
Gjatë gjithë procedurës, ekspertët e jashtëm të vlerësimit janë asistuar nga Koordinatori Teknik i ASCAL: Znj. Xhiliola Bixheku.
Me datë 22.06.2018 dërgohet në Institucion Draft Raporti i Vlerësimit të jashtëm i hartuar nga ekspertet e vlerësimit. Më datë 26.06.2018 Institucioni sjell në ASCAL përgjigjen në lidhje me Draft – RVJ, për të cilin nuk kishite asnjë koment. Draft – RVJ kthehet në Raport përfundimtar.

GVJ u trajnua nga specialistë të ASCAL të cilët treguan gadishmërinë e tyre për tu konsultuar në vazhdimësi të këtij procesi si dhe mbeshteten GVJ gjate gjithe procesit te vleresimit dhe hartimit te raportit te vleresimit.

Ky raport paraqet një analizë të hollësishme për veprimtarinë e Departamentit të Fizioterapisë në Universitetin "ALDENT" si dhe një analizë të thellë mbi vlerësimin e jashtem të cilësisë së procesit mësimor të programit Bsc. në "FIZIOTERAPI" të ofruar nga ky institucion, progresin e arritur dhe vështirësitë e hasura në periudhën 2012-2018.

Për hartimin e raportit, GVJ ka zhvilluar vizita ne mjediset e universitetit, auditore, laboratore etj si dhe takime dhe diskutime me anëtarë të stafit akademik, administrativ e ndihmës si dhe studente të Universitetit "ALDENT, ka analizuar me imtesi raportin e GVB si dhe te gjithe dokumentacionin shoqerues te paraqitur nga universiteti ALDENT.

GVJ është përpjekur të analizojë aktivitetin akademik dhe administrativ, duke evidentuar dhe pasqyruar arritjet, nevojat, si dhe problematikat e hasura në periudhën gati 6 vjeçare.

Raporti fillimisht ka per qellim te vleresoje nese jane arritur rekomandimet e lena gjate procesit te meparshem te riakreditimit dhe me pas te analizoje gjendjen aktuale te cilesise se programit qe ofrohet dhe te jape rekomandimet e duhura per te ardhmen.

Vlerësimi objektiv i këtij raporti nga ana e universitetit dhe stafit te tij akademik shërben për të analizuar sidomos pikat e forta dhe te dobta te universitetit si dhe te ketij programi studimi me qellim vendosjen e objektivave te qarta per te ardhmen ne permirsimin dhe perfeksionimin e programit te studimit ne te mire te vete universitetit dhe studenteve por edhe shkences se fizioterapise ne pergjithsi.

Raporti i vlerësimit të jashtem është rezultat i kontributit të dhënë nga i gjithë stafi pjese e GVJ si dhe stafit te ASCAL por dhe suportit te stafit te universitetit ALDENT .

GVJ shpreh mirënjohjen dhe falënderimet për të gjithë ata që kontribuan në përgatitjen e këtij raporti.

## ANALIZË PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA KA NË VENDIMIN PËR AKKREDITIMIN E PARË

### I. Rekomandimet e Këshillit të Akreditimit

1. Të synohet rritja e nivelit të bashkëpunimit me sektorin public dhe privat jo vetëm për realizimin e praktikave profesionale por edhe për të punësuar në të ardhmen studentët e diplomuar.
2. Institucioni të fokusohet në rekrutimin e pedagogëve të brendshëm në këtë program studimi edhe pse ngarkesa mësimore është relativisht e ulët nisur nga numrii studentëve.
3. Të vendosen kritere pranimi të studentëve gjatë procesit të regjistrimit përfshirë këtu edhe notën mesatare të shkollës së mesme.
4. IAL të hartojë politika afatgjata zhvillimi dhe ecurie të programit mësimor duke filluar me procesin e informimit dhe më pas përcaktimin e strategjisë për çdo vit akademik

### II. Plotësimi i tyre nga Institucioni

1. Në lidhje me rekomandimin e Këshillit të Akreditimit për programin Bachelor në "Fizioterapi" për rritjen e nivelit të bashkëpunimit me sektorin publik dhe privat jo vetëm për realizimin e praktikave profesionale por edhe për të punësuar në të ardhmen studentët e diplomuar, Universiteti ALDENT ka realizuar marrëveshje bashkëpunimi me një sërë institucionesh të shërbimeve shëndetësore me qëllim aktivizimin gjatë praktikave mësimore. Nga marreveshjet e shqyrtuara del që universiteti ka lidhur kontrata për praktikën e fizioterapisë me institucionet me kryesore dhe më

të mira në vend, në këtë mënyrë studentet e kanë mundësinë të kryejnë orët e praktikës së nevojshme pranë këtyre strukturave duke prekur realisht rastet klinike nga ana praktike.
Institucioni paraqiti evidencë për kryerjen e marrëveshjeve me klinika fizioterapie me qëllim jo vetëm zhvillimin e praktikave por edhe punësimin në prespektivë të studentëve më të spikatur. Në takimin me studentët, dy prej tyre që aktualisht vazhdonin studimet master në ALDENT ishin punësuar në klinikat e pedagogëve ku më parë kishin kryer praktikat klinike.
Pra kjo dhe praktikat në vete universitet përmbushin më se miri këtë rekomandim.
**Ky rekomandim është realizuar.**

2. Në lidhje me rekomandimin e Këshillit të Lartë të Akreditimit për programin Bachelor në "Fizioterapi" për rekrutimin e pedagogëve të brendshëm në këtë program studimi është rritur numri i pedagogeve efektive dhe është arritur të gjendet një barazpeshe midis tyre dhe pedagogeve të jashtëm duke synuar që secilin lëndë ta japë profesionisti më i mirë në fushën e caktuar duke patur parasysh se kemi të bëjmë me programe mjaft specifike studimi. Cdo vit ka ardhur në rritje numri i pedagogëve të brendshëm krahasuar me ato të jashtëm, edhe pse vlen te thekesoshet se PAE nuk shërben vetëm për këtë program studimi por për edhe për programe të tjera studimi.
**Ky rekomandim është realizuar.**

3. Në lidhje me rekomandimin e Këshillit të Akreditimit për programin Bachelor në "Fizioterapi" për sa i përket kritereve të pranimit të studentëve gjatë procesit të regjistrimit kjo për vitet e fundit është realizuar edhe në mbështetje të udhezimeve të MASH pra në bazë të notës mesatare.
Është parë një rritje e notës mesatare të shkollës së mesme në hyrje përgjatë viteve.
Në vitet e mëparshme përvec notës mesatare dhe kërkesës për të studiuar në atë program studimi universiteti nuk ka aplikuar kritere te tjera shtese si psh test pranimi, etj, por eshte bere aplikuar nje sistem vleresimi sipas lendeve preferenciale per programin e studimit, pa futur kritere shtese per perzgjedhjen e studenteve sikurse është kryer edhe në instiucionet publike që ofrojnë këtë program. Krahasuar me pranimin e studentëve në institucione të tjera private dhe publike si dhe nga eksperiencat e pranimeve jashtë vendit në të njëjtin program studimi mendojmë se ky kriter konsiderohet i plotësuar.
**Ky rekomandim është realizuar.**

4. Në lidhje me rekomandimin e Këshillit të Akreditimit për programin Bachelor në "Fizioterapi" për hartimin e politikave afatgjata zhvillimi dhe ecurie të programit mësimor duke filluar me procesin e informimit dhe më pas përcaktimin e strategjisë për çdo vit akademik, u pa Universiteti ALDENT ka përpiluar strategji të lidhura me zhvillimin e programit të Fizioterapisë. Kjo stategji na u vu në dispozicion nga IAL gjatë vizitës në vend. Institucioni ka bërë përpjekje të vazhdueshme për përmirësimin e programit duke mbajtur në vëmendje përfshirjen brenda fushave të studimit të lëndëve që janë ngushtësisht të lidhura me kërkesat e tregut të punës për një të diplomuar Bachelor në fizioterapi.
Ka evidenca te mjaftueshme qe stafi i UAL ka marrë pjesë në aktivitete të lidhura me rritjen e vazhdueshme të cilësisë duke përfshirë këtu si pedagogët dhe studentët.
IAL ka vendosur objektiva të përvitshme zhvillimi me synim përmirësimin e cilësisë, të cilat monitoroheshin dhe vlerësoheshin për efektivitetin e tyre nëpërmjet instrumentave të vendosura nga Njësia e Brendëshme e Sigurimit të Cilësisë.
**Ky rekomandim është realizuar.**

## ADMINISTRIMI I NJËSISË NË SHËRBIM PROGRAMIT TË STUDIMIT

### 1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

Misioni dhe Objektivat e programit të studimit

Objektivi i pergjithshem i programit eshte te formoje fizioterapiste profesionistë. Per te arritur kete ky program duhet te ti kushtoje nje rendesi te vecante fitimit te aftesive dhe qendrimeve te duhura qe do te sherbejne ne aplikimin ne praktike te trajtimeve fizioterapeutike. Ne nje mjedis qe ndryshon ne menyre te vazhdueshme, fizioterapistet e ardhshem duhet te jene te paisur jo vetem me njohurite e duhura teorike por edhe te jene fleksibel dhe ti pershtaten ndryshimeve. Eshte nje sfide e veshtire ti mbijetosh botes komplekse te shkencave mjeksore dhe perqasja e kurikulumit duhet te jete jo vetem shkencore e profesionale por edhe ideologjike e sociale.

Ky program bazohet në formimin e profesionistëve të ardhshëm në fushën e fizioterapisë dhe orientimin e tyre për të arritur per tu punesuar dhe punuar ne menyre dinjitoze dhe profesionale si brenda ashtu edhe jashtë vendit. Studenti gjatë gjithë periudhës së studimit aftësohet të aplikojë teknikat më aktuale rehabilituese në mënyrë praktike si në auditor ashtu edhe në praktikat spitalore që shoqërojnë procesin e formimit të tij profesional. Ky program mësimor është ndërtuar t'i orientojë studentet që të rendisin indikatorët dhe kundraindikatorët e llojeve të ndryshme të terapive si manuale ashtu edhe instrumentale të modaliteteve të ndryshme fizike.

Ne terma te pergjithshem ky program afteson praktikante te pergjithshem te fizioterapise te cilet duhet te paisen me njohurite teknike e shkencore te nevojshme pergjate tre viteve te studimit per te identifikuar e trajtuar problem te ndryshme shendetsore qe I pergjigjen mire terapise me ane te fizioterapise. Per te arritur nje gje te tille studentet aftesohen me njohuri teorike dhe jane te afte te zbatojne ne praktike metoda, procedura, modele e teknika ne aplikimin e principeve terapeutike fizike per te trajtuar ne menyre efikase persona me aftesi fizike te limituara, paaftesi apo ndryshime fizike si pasoje e nje demtimi, semundjeje apo shkaqe te tjera.
Por pervec kesaj programi I studimit permban praktika mjekesore te tilla qe te aftesoje studentet te promovojne nje shendet te mire per te parandaluar semundjet apo pasojat.
Ky program mësimor është i ndërtuar t`i orientojë dhe aftësojë studentët në një fushë mjaft specifike dhe në të njëjtën kohë t`i përgatisë për provimin e shtetit.
Objektivat e programit të fizioterapisë realizohen nëpërmjet mësimdhënies të paralelizuar si teorike ashtu edhe praktike. Per shkak te vete natyres se programit pjesa praktike mbart nje pjese te rendesishme te formimit te nje fizioterapisti te ardhshem dhe duhet ti kushtohet nje rendesi e vecante duke e gershetuar qarte me pjesen teorike.

Studenti merr njohuritë teorike në auditoret përgjatë një procesi mësimdhenieje interaktiv. Përgatitja e studentit nga ana praktike kryhet në laboratoret modern të fizioterapisë që shkolla ofron si dhe nëpërmjet bashkëpunimit me spitalet dhe institucionet shëndetësore.

Studenti ne fund te programit tre vjecar te studimit duhet te jete i afte te:

1. Te kete njohuri te qendrueshme dhe te kuptoje teorine, metodat, teknikat dhe instrumentat ne te cilat bazohet shkenca e fizioterapise.
2. Te dije e zbatoje metodat, procedurat dhe veprimet qe pritet ne nderrmarre ne kontekste klinike te ndryshme por edhe te promovoje fizioterapine si mjet edukimi per te promovuar e ruajtur shendetin.

3. Te fitoje experience klinike te mjatueshme per te patur aftesi intelektuale dhe manuale, te perqafoje vlera etike dhe profesionale dhe te zhvilloje aftesi per te aplikuar njohurite qe merr gjate programit ne situate klinike si ne spitall ashtu dhe gjate sherbimit ambulator etj
4. Te vleresoje statusin funksional te pacienteve bazuar ne nevojat e tyre fizike, psikologjike dhe sociale.
5. Te jete I afte te aplikoje kritere diagnostike ne fushen e tij te kompetences ne baze te standarteve te njohura nderkombetare.
6. Te planifikoje nderhyrje fizioterapeutike bazuar ne kritere te qarta te mjekesise bazuar ne fakte, eficente dhe te validuara.
7. Te arrije te vleresoje nese nderhyrja ka arritur rezultate te pritshme dhe te riplanifikoje nderhyrjen.
8. Te pergatise raporte vleresimi ne fund te cdo trajtimi apo nderhyrjeje fizioterapeutike.
9. Te marre pjese ne veprimtari te edukimit ne vazhdim, kerkime etj

Ky program studimi ka si mision:

- Të pajisë studentët me njohuritë dhe aftësitë e duhura për të formuar specialistë fizioterapistë të aftë të konkurrojnë në tregun vendas dhe të huaj, si dhe të përballin me sukses kërkesat në rritje të tregut të punës.
- Të kontribuojë në zhvillimin, emancipimin dhe rritjen e standardeve të shkencës së fizioterapisë duke përgatitur të rinjtë për të qenë pjesë e denjë e saj.

Qëllimi i programit Bachelor "Fizioterapi" në Universitetin "ALDENT" është përgatitja e studentëve me njohuri teorike dhe praktike të nevojshme për këtë disiplinë si dhe pajisja e tyre me kompetenca bazë për studime të mëtejshme, specializime apo trajnime profesionale.

**Vlerësimi sipas Standardeve**

| **Standardet/kriteret** | **Vlerësimi sipas standardeve**[1] |
|---|---|
| **I - OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE**<br>**Standardi I. 1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.** | |
| **Kriteri 3** Programet e studimeve hartohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit;<br><br>**Kriteri 4** Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit;<br><br>**Kriteri 5** Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës; | Qëllimi dhe misioni i programit te studimit te Fizioterapise është në perputhje te plote me me misionin dhe qëllimin e UAL. Programi i studimit Bachelor në "Fizioterapi" ka si objektiv pajisjen e studentëve me njohuri të nevojshme, profesionale, shkencore, vlera etike dhe morale në aplikimin e profesionit te fizioterapistit.<br>Ky program studimi ka objektiva të qarta profesionale që synojnë përgatitjen e profesionistëve në fizioterapi, me njohuri e kompetenca të nevojshme fizioterapeutike profesionale teorike dhe praktike, të aftë të punojnë në sektorin e rehabilitimit. Kombinimi i veprimtarive formuese, leksionet teorike dhe aktivitetet akademike, praktika profesionale brenda |

[1] GVJ duhet të shprehen me shkrim për të **gjitha standardet** (bazuar në kriteret përkatëse). Në fund të çdo rubrike grupi duhet të japë mendimin e tij për përmbushjen e standardit në tërësi.

| | |
|---|---|
| **Kriteri 6** Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit. | dhe jashte universitetit bën të mundur paisjen e studentëve me njohuritë dhe aftësitë e duhura profesionale dhe shkencore, si dhe pajisjen e tyre me vlera etike dhe morale në aplikimin e profesionit. Plani dhe programi mësimor është përmirësuar ndjeshem duke futur elemente dhe praktika te reja me qëllim përshtatjen me ndryshimet ligjore dhe kërkesat në rritje të tregut të punës për këtë profesion si brenda ashtu edhe jashtë vendit. Vihet re që Brenda cdo moduli lënde ka përmirsime dhe ndryshime të temave dhe përshtatje të tyre nga viti në vit. |
| **Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.** | |
| **Kriteri 1** Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;<br><br>**Kriteri 2** Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë pajisjen me njohuritë bazë, mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme;<br><br>**Kriteri 3** Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë dhe formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionesh e specialitetesh.në realizimin e misionit dhe qëllimit të institucionit; | Programi I studimit eshte I pershtatur mjaft mire me strategjine e zhvillimit te institucionit duke ecur ne nje linje me te. Kete e mbeshtet dhe fakti qe universiteti eshte teresisht I fokusuar ne shkencat mjekesore duke pasur perparesi ne kete drejtim.<br>Program I fizioterapise ka për objektiv të formojë profesionistë të cilët kanë kryer studimet e mesme dhe duan të studiojnë në fushën e fizioterapisë. Diploma ka karakter profesional për të krijuar në harkun e tre viteve njohuritë bazë dhe të aplikuara të profesionit të fizioterapistit. Ky program studimi është i dizenjuar në mënyrë të tillë që synon: Pajisjen e të diplomuarve me një formim kulturor dhe profesional të avancuar, për ti bërë të aftë të ndërhyjnë me kompetencë në procese rehabilitmi dhe kërkimi në fushën e Fizioterapisë. Pajisjen e të diplomuarve me njohuritë e duhura në lidhje me formimin e bazës kulturore për procesin e aplikimit të profesionit në dimensione tekniko - shkencore, ligjore dhe deontologjike që rregullojnë aktivitetin e lirë profesional, organizatat shëndetësore dhe përgjejësitë profesionale. Gjate programeve te studimit studentet fitojne si njohurite baze te profesionit te fizioterapistit por edhe me gjere. |
| **II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE**<br>**Standardi II.1 - Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës.** | |
| **Kriteri 1** Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës, në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;<br><br>**Kriteri 2** Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin: | Programi i studimit mbështetet mbi objektiva të qartë profesionalë, te kuptueshme, realiste, të arritshëm me synime të qarta për kualifikimin e nevojshëm te studenteve dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe strategjitë e reja të zhvillimit të këtij profesioni. Programi i studimit "Fizioterapi", renditet ndër programet më të kërkuara nga maturantët, pasi vitet e fundit është rritur kërkesa në tregun vendas dhe |

| | |
|---|---|
| a. mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, kombëtar e ndërkombëtar;<br>b. kërkesat e punëdhënësve;<br>c. një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program;<br>d. numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra. | të huaj.<br>Këtë e vërteton fakti që vitet e fundit janë regjistruar shumë më tepër studentë se në vitet e mëparshme.<br>Numri i pritshëm për këtë program studimi i paraqitet nga universtieti MASR çdo fillim viti duke patur parasysh kapacitetet infrastrukturore dhe burimet njerëzore në dispozicion për të ofruar një proces cilësor mësimor, që ka rezultuar në rritje vit pas viti. Mbas verifikimit të kapaciteteve pritëse jepet aprovimi nëse gjithçka është në përputhje me ligjin dhe aktet nënligjore në fuqi. |
| **Standardi II.2 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.** | |
| **Kriteri 1** Institucioni ofron programe studimesh që nuk bien ndesh me interesat kombëtare;<br><br>**Kriteri 2** Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare. | Universiteti Aldent nëpërmjet programeve të studimit që ofron synon të ruajë vlerat kulturore kombëtare siç janë gjuha, historia, simbolet kombëtare, traditat dhe të përgatisë profesionistë të ardhshëm që do t'i lartësojnë këto vlera. |

**Konkluzionet e vlerësimit:**

1. Programi I studimit ne fizioterapi eshte hartuar në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit; ka objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në kete program, keto objektiva jane te arritshme, realiste, te kuptueshme e te qarta. Ne perfundim te programit te studimit studentet jane te afte te kene aftesite profesionale te nevojshme per tregun e punes si dhe te jene pjese konkuruese e denje e tij.

2.Programi eshte hartuar ne baze te nevojave te profesionit si dhe te tregut te punes dhe zhvillimit ekonomik te vendit qe ka kerkesa ne rritje per nje profesion te tille.

3. Programi i studimit eshte i përshtatur me se miri me strategjinë e zhvillimit te universitetit duke paisur fillimisht studentet me njohurite baze e me pas me njohuri specifike ne profesionin e tyre bazuar ne praktikat me te mira profesionale bashkekohore.

4. Programi ploteson nevojat e tregut per profesioniste ne fushen e fizioterapise.

**Standartet plotesohen**

## 2. Struktura akademike e Fakultetit (përgjegjës për programin e studimit)

**Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

Struktura organizative e universideitit ALDENT eshte percaktuar ne baze te ligjit Nr 80/2015 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Në Statutin e universitetit "ALDENT" është përcaktuar struktura organizative e institucionit. Po kështu janë përcaktuar njësitë përbërëse me funksionet e kompetencat, vendin që zënë në strukturë, lidhjet e varësitë që kanë ndërmjet tyre, personelin që i përbëjnë, me qellim permbushjen e misionit dhe objektivave qe ky universitet i ka vene vetes.

UAL përbëhet nga Njësitë Organizative kryesore, bazë dhe ndihmëse.

Njësitë kryesore

Fakulteti është njësi kryesore, që bashkërendon mësimdhënien, kërkimin shkencor dhe zhvillimin kulturor duke u dhene mundesi studenteve te arrijne me te miren e tyre ne fusha dhe disiplina te ndryshme sipas programeve te studimit. Fakulteti ofron programe të studimeve të llojeve dhe niveleve të ndryshme në përfundim të të cilave përfitohet diplomë.

Fakulteti organizohet në tri njësi bazë, nga të cilat dy janë departamente. Struktura, përbërja, funksionimi, detyrat si dhe drejtimi, përcaktohen në rregulloren e secilit Fakultet (Aneks 7. I RVB, Rregullore e FSHMT).

Aktualisht Universiteti "Aldent" e organizon aktivitetin akademik mbështetur në Urdhërin e Ministrit të Arsimit Sportit dhe Rinisë Nr. 115, datë 13.03.2017 në tre Fakultete si më poshtë:

a. Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike
b. Fakulteti i Shkencave Mjekësore
c. Fakulteti i Shkencave Dentare

DEKANI- Dekani është drejtues i Fakultetit dhe emërohet në detyrë nga rektori me pëlqimin e Presidentit të UAL, për një periudhë 4-vjecare me të drejtë rizgjedhje. Marrëdhëniet ndërmjet personit juridik dhe dekanit përcaktohen në kontratën e punës. Dekani duhet të ketë së paku titullin "Profesor" dhe kompetencat e tij përshkruhen në dokumentat rregullatorë të universitetit dhe mbështeten në legjislacionin arsimor aktual. Kompetencat e Dekanit pershkruhen ne dokumetat rregullatore dhe zbatohen me perpikmeri gje qe u vertetua ne takimet me drejtuesit.

Dekani i Fakultetit eshte Dr. Nedime Ceka. Edhe pse mban graden Doktore e Shkencave ajo eshte nga mjeket ekperte me te mira kombetare ne fushen e shendetit publik, shendetit te nenes dhe femijes, pedagoge me eksperience prej shume vitesh ne pediatri si ne institucionet universitare publike dhe private (Fakulteti Mjekesise dhe UAL lenda pediatri). Gjithashtu eshte koordinatore e disa projekteve kombetare ne disa fusha te rendesishme te mjekesi.

Vlen gjithashtu te theksojme qe prej disa kohesh prane Universitetit te Mjekesi eshte bllokuar dhenia e titujve dhe gradave per personelin akademik, cka e bene akoma edhe me te veshtire angazhimi/punesimin e personelit akademik me tituj.

**Njësitë Bazë**

Departamenti është njësi bazë mësimore-kërkimore, që përfshin fusha kërkimi homogjene dhe grupon disiplinat mësimore përkatëse. Departamenti nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore-shkencore duke respektuar liritë akademike të personelit mësimdhënës. Strukturë të ngjashme me departamentin kanë edhe Qendrat e Kërkimit dhe Zhvillimit, fushat e kërkimit të të cilave harmonizohen me interesa të departamenteve të Fakultetit.

Njësitë bazë të Universitetit "Aldent" janë:

- Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë
- Departamenti Laborant Mjekësor dhe Imazheri
- Qendra e Promovimit të Shëndetit Fakulteti i shkencave mjekësore
- Departamenti i Farmacisë
- Departamenti i Formimit Mjekësor
- Qendra kërkimore Farmakoterapeutike Fakulteti i Shkencave Dentare
- Departamenti i Stomatologjisë
- Departamenti i Laborantëve Dentare
- Qendra e Shëbimit dhe Formimit klinik

Departamenti Infermieri dhe Fizioterapi aktualisht ofron dy programe të ciklit të parë Bachelor në " Infermieri të përgjithëshme", "Fizioterapi" dhe një program të ciklit të dytë Master shkencor në "Fizioterapi klinike".

PËRGJEGJËSI I DEPARTAMENTIT- Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se përgjegjësi i departamentit është drejtues i departamentit dhe emërohet në detyrë nga rektori me pëlqimin e dekanit dhe Presidentit të ALDENT. Përgjegjësi i departamentit përgjigjet për të gjitha veprimtaritë e departamentit dhe kompetencat e tij përshkruhen në dokumentat rregullatorë të brendshëm dhe mbështeten në legjislacionin arsimor aktual (Aneks 8.i RVB, Rregullore e Departamentit Infermieri dhe Fizioterapi). Në rregulloren e brendshme të Fakultetit parashikohet organizimi i punës për planifikimin dhe miratimin e stafit që do të angazhohet dhe nevojat për rekrutimin e stafit të ri akademik dhe joakademik për departamentin përkatës.
Nga vizita në institucion, takimet e kryera me drejtuesit dhe stafin akademik evidentuam se kompetencat dhe përgjjegjësitë respektohen dhe zbatohen më së miri ashtu sikurse përshkruhet në dokumentat rregullatorë të Universitetit ALDENT.

☑ Nga shqyrtimi I dosjes se vleresimit dhe te dhenave te deklaruara nga universiteti ALDENT gjate raportit te vleresimit te brendshem si dhe gjate vizites ne universitet nuk vihen re ndryshime ne organizmin hierarkik te fakuletit si dhe strukturen e tij akademike dhe menyren e organizmit.

**3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit**
**<u>Vlerësimi i Treguesve të matshëm:</u>**

☑ Struktura didaktike (seksionet) për departamentet ose programin e studimit
Programi I studimit bachelor ne fizioterapi ofrohet nga Departamenti i Infermierise dhe Fizioterapise.
Departamenti është kujdesur që shpërndarja e ngarkesës të jetë në përputhje më specialitetin e stafit, standartet e përcaktuara për ngarkesat e normuara si edhe për të lënë hapësira për angazhime të tjera të kërkimit dhe hulumtimit shkencor.
Departamenti përfshihet në procesin e rekrutimit të stafit akademik i cili bëhet në disa faza gjë që u konfirmua edhe nga stafi i ri gjatë takimit të GVJ me stafin e angazhuar në këtë program studimi.
Njësitë ndihmëse Laboratorët, njësitë didaktike, biblioteka dhe njësi të tjera që realizojnë studime, projektime dhe ofrojnë shërbime, konsiderohen Njësi Ndihmëse. Njësitë ndihmëse bashkëpunojnë me njësitë kryesore dhe njësitë bazë, në funksion të realizimit të misionit dhe objektivave të institucionit.

☑ Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat,

Stafi akademik ne programin e studimit bachelor ne fizioterapi konsistonte ne personel akademik efektiv (PAE) dhe personel akademik me kontrate(PAK). Duhet theksuar se ky staf akademik nuk eshte staf ekskluziv i programit bachelor ne fizioterapi por i gjithe departamentit infermieri-fizioterapi apo dhe programit master fizioterapi duke qene se te dyja keto programe studimi jane te ngjashme me njera tjetren. Përveç pedagogëve me tituj e grada, për lëndet e karakterit të

përgjithshëm formues, në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike janë punësuar edhe pedagogë me Master shkencor apo Specializime Afatgjatë, por që kanë një eksperiencë specifike e të suksesshme në profesionin e fizioterapeutit. Disa prej ketyre pedagogëve kanë mbaruar studimet ose janë specializuar jashtë vendit. Materiali mbi ngarkesen e stafit efektiv u kerkua nga GVJ gjatë vizitës ne UA për të dy programet edhe Bsc edhe Msc në Fizioterapi. Ngarkesa e stafit akademik te angazhuar ne kete program ndodhet në system. Disa nga pedagogët me kohë të plotë të angazhuar në mësimdhënien e programit Bsc për vitin akademik 2017-2018 rezultojnë në total me një numër të madh lëndësh.

Ne departamentin e Infermieri dhe fizioterapise per vitin akademik 2017-2018 jane te angazhuar 18 pedagoge. Nga keta 10 jane PAE dhe 8 jane PAK. (Tabelat ne fund te raportit)
Ne programin e studimit per vitin akademik 2017-2018 jane angazhuar ne mesimdhenie 38 pedagoge nga keta 19 PAE dhe 19 PAK. Duhet theksuar qe ka nje numer te madh pedagogesh PAK por nga takimet na u sqarua se ka nje numer te madh per arsye te anagazhimit ne cdo modul te specialisteve te fushes dhe ngarkesa e oreve ne auditor mbulohej 71% nga stafi i brendshem dhe 29% nga stafi me kontrate. Ky raport per vitin akademik 2015-2016 kane qene te angazhuar 35pedagoge, nga te cilet 15 PAE (43%) dhe 20 PAK (57%). Per vitin akademik 2016 -2017 kane qene te angazhuar 36 pedagoge, nga te cilet 15 PAE (42%) dhe 21 PAK (58%). Duke analizuar 3 vitet e fundit akademike, vihet re qendrueshmeri e stafit akademik i cili eshte angazhuar ne kete program studimi.

Shihet se nese ne vitet e para kishte nje predominim te PAK krahasuar me PAE; tendence kjo qe zgjat deri ne vitin 2016-2017; vitin e fundit akademik ka nje barazim ne numer te PAK me PAE. Pra universiteti ka ndjekur politike stimuluese per te punuar staf me kohe te plote, pjese ekskluzivisht e universitetit ALDENT.

Vihet re qe departamenti i fizioterapise dhe infermierise ka nje numer te konsiderueshem pedagogesh qe perbejne pjesen me te madhe te pedagogeve te fakultetit te shkencave mjekesore teknike.

☑ Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre (Tabela, ne Aneks)

Shikohet se stafi ka nje kualifikim mjaft te mire duke pasur ne gjirin e vet staf me tituj akademik prestigjioze si Prof. As, Doktor etj. Dihet qe eshte e veshtire te gjesh specialiste ne fushen e fizioterapise me tituj dhe universiteti ka bere nje pune te mire ne perthithjen e stafit me te mire te mundshem. Te gjitha lendet jepen nga speciliste te fushave perkatese.

Raporti pedagoge/student nder vite eshte si me poshte:

- Për vitin akademik 2012-2013, në programin e Fizioterapisë raporti pedagog /student ishte: 1/7.7
- Për vitin akademik 2013-2014, në programin e Fizioterapisë raporti pedagog /student ishte: 1/3.4
- Për vitin akademik 2014-2015, në programin e Fizioterapisë raporti pedagog /student ishte: 1/3.2
- Për vitin akademik 2015-2016, në programin e Fizioterapisë raporti pedagog /student ishte: 1/4.6

- Për vitin akademik 2016-2017, në programin e Fizioterapisë raporti pedagog /student ishte: 1/4.8
- Për vitin akademik 2017-2018, në programin e Fizioterapisë raporti pedagog/student është:1/5.3

  Pervec vitit te pare shihet se ka nje qendrueshmeri te raportit pedagog /student pak e shume te njejte pergjate viteve.

Ndarja e ngarkesë së studentit për komponentët e lëndës është realizuar në përputhje me rekomandimet e udhëzimit për organizimin e programit mësimor.

Ndarja e lëndëve në disiplina nga A te F gjithashtu është ndarë në mënyrë korrekte në përputje me karakteristikat e programit të studimit si dhe udhëzimet e MASR

| Fizioterapi | Fusha Disiplinore | Nr. i krediteve dhe % | |
|---|---|---|---|
| *A* | Lëndë të formimit bazë | 43,5 | 24.16% |
| B | Lëndë karakterizuese | 90 | 50% |
| C | Lëndë integruese, te ngjashme | 21 | 11.66% |
| D | Lëndë formuese per njohjen e gjuhes se huaj | 6.5 | 3.61% |
| E | Lëndë me përzgjedhje | 12 | 6.67% |
| F | Provim Formimi | 7 | 3.9% |
| | | 180 | 100 % |

Në të gjitha modulet është aktivizuar në mësimdhënie specialist i fushës, tabela specifike gjendet në anekset e këtij raporti.

☑ Të dhënat sipas seksit

Te dhenat sipas seksit jepen ne tabelen me poshte:

| **Viti akademik** | **Femra** | **Meshkuj** |
|---|---|---|
| **2015-16** | **23** | **11** |
| **2016-17** | **22** | **13** |
| **2017-18** | **26** | **12** |

Stafi i PAE dhe PAK kishte nje shumellojshmeri moshe ashtu sic duket dhe ne tabelen me poshte. Ky mendohet se eshte nje pike e forte e programit duke patur parasysh qe kombinohen eksperienca dhe pikeveshtrime te ndryshme sigurisht duke permbushur kriteret baze te punesimit.

Te dhenat sipas moshes jepen ne tabelen me poshte:

| Personeli sipas titujve /gradave | Numri i PAE me moshë, për vitin akademik 17-18 | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | (25-35) | (36-45) | (46-55) | (56-65) | (66-68) |
| Profesorë | | | | | |
| As. Prof | | | 1 | 3 | 1 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Doktorë/SPA | 1 | | | 2 | |
| Pedagogë ne proces Dr | 1 | | | | |
| Pedagogë (pa tituj) | 9 | | 1 | | |

PAK me mosha

| Personeli sipas titujve /gradave | Numri i PAK me moshë, për vitin akademik 2017-18 | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | (25-35) | (36-45) | (46-55) | (56-65) | (66-68) |
| Profesorë | | | | | |
| As. Prof | | 1 | 1 | 1 | |
| Doktorë/SPA | 4 | 5 | 3 | 1 | |
| Pedagogë (pa tituj) | | 1 | | 1 | |

☑ Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat

Procesi i rekrutimit te stafit si per PAE ashut dhe per PAK ndjek nje procedure te mirepercaktuar. Eshte departamenti ai qe përfshihet në procesin e rekrutimit të stafit akademik i cili bëhet në disa faza.

Gjate vizites ne institucion u kerkuan nga zyra e burimeve njerezore nje procedure random per te pare hapat qe u ndoqen per rekrutimin e personelit si dhe menyres se vleresimit te te gjithe kandidateve perfshire dhe fituesin. U pa qe universiteti ka nje sistem te mirepercaktuar per vleresimin si dhe indikatore e process pikezimi te qarte per vleresimin e cdo kandidati.

Per cdo person pjese e stafit te PAK ose PAE lidhej nje kontrate pune ne te cilen saktësohen te drejtat dhe detyrimet sipas legjislacionit ne fuqi. Gjate vizites u kerkua dhe perzgjodh random nje kontrate pune per verfikim dhe u konstatua se kontrata e punës me Universitetin "Aldent" është e hartuar në bazë të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, "Kodi i Punës", i amenduar nga ligji nr.8085, datë 13.03.1996, i amenduar nga ligji nr.9125, datë 29.07.2009, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore për marrëdhëniet e punës në Republikën e Shqipërisë, si dhe në përputhje me ligjin nr.7850, datë 29.07.1994 "Kodi Civil në Republikën e Shqipërisë", i amenduar nga ligji nr.8536, datë 18.10.1999 dhe ligji nr.8781, datë 03.05.2001 dhe ligji Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", si dhe me aktet ligjore dhe nënligjore për Arsimin e Lartë Privat, me Statutin dhe Rregulloret e Brendshme të "Universitetit Aldent"

☑ Cilësia e stafit ndihmës/ administrativ për çdo njësi bazë

Stafi ndihmes eshte pjese e rendesishme jo vetem e nje universiteti por edhe e cdo agjensie qofte publike apo private. Pa te asnje element i procesit mesimor apo me gjere nuk do te ishte e mundur. Cilesia e stafit ndihmes u gjet shume e mire. Jo vetem gjate vizites ne universitet por edhe ne menyre te terthorte nga feed-back-u i studenteve u pa se stafi ndihmes duke filluar nga biblioteka mesimore deri tek sekretaria etj, permbushte me se miri detyrat e pershkruara ne pershkrimin e punes por edhe me gjere duke asistuar e ndihmuar studentet edhe ne pershtatjen dhe orientimin me nje faze te re te jetes, ate te studentit.

**Sikurse ishte përshkruar në RVB u konfirmua se të gjitha të dhënat e dokumentuar u evidentuan të përputhshme gjatë vizitës në institucion.**

☑ Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion
- *lista e stafit akademik,*
- *procedura e rekrutimit. Etj*

**Vlerësimi sipas Standardeve**

| **Standardet/kriteret** | **Përmbushja e standardeve** |
|---|---|
| **III - PERSONELI I INSTITUCIONIT**<br>**Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit dhe vlerësimit të personelit.** | |
| **Kriteri 1** Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit të personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;<br><br>**Kriteri 2** Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të parë;<br><br>**Kriteri 3** Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;<br><br>**Kriteri 4** Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për punë, etj. | Universiteti ALDENT ndjek nje procedurë të përcaktuar qarte për punësimin e personelit akademik me kohe te plote dhe me kontrate, e cila kalonte në disa hallka të përcaktuara në dokumentat rregullatorë të institucionit.<br>Fakulteti në bashkëpunim me zyrën e Burimeve Njerëzore mbaheshin rekordet e procesit të rekrutimit dhe të të dhënave të kandidatëve aplikues si dhe shpalljen e fituesve.<br>U pa se kishte rekorde te plota dhe proces I realizuar ashtu sic raportohej per rekrutimin e stafit akademik dhe ishte realizuar dhe pikezimi ne baze te aftesive profesionale si dhe renditja e shpallja e fituesit.<br>Gjate vizites ne zyren e Burimeve Njerezore u pa se kishte dosje individuale per cdo anetar te stafit akademik, qofte ky PAE apo PAK. Ne programin e studimit jane angazhuar ne mesimdhenie 38 pedagoge nga keta 19 PAE 19 PAK . Duhet theksuar qe ka nje numer te madh pedagogesh PAK por nga takimet na u sqarua se ka nje numer te madh per arsye te anagzhimit ne cdo modul te specialisteve te fushes dhe ngarkesa e oreve ne auditor mbulohej 71% nga stafi i brendshem dhe 29% staf me kontrate, llogaritur kjo direkt gjate vizites ne institucion. Ky raport ka ardhur duke u permiresuar duke analizuar 3 vitet e fundit akademike.<br>Bazuar në Statutin dhe Rregulloren e UAL, senati akademik ka miratuar edhe formularin për vlerësimin e performancës së personelit akademik në përputhje me të drejtat dhe detyrat të përshkruara në formularin e përshkrimit të punës. Ky formular i vlerësimit të performancës akademike vlerëson arritjet e personelit duke u mbështetur në faktorë si mësimdhënia, dhënia e asistencës dhe konsultimeve të programuara me studentët; kërkimi shkencor, pjesëmarrja në seminare, |

| | |
|---|---|
| | konferenca, kongrese workshop të programuara nga institucioni, botimet shkencore dhe nxitja e tyre për të ardhmen si dhe angazhimi administrative, efikasiteti i kohës së punës në mësimdhënie apo në mbështetëse për institucionin gjatë një viti akademik. Fakulteti në bashkëpunim me zyrën e Burimeve Njerëzore mban rekordet e procesit të rekrutimit dhe të të dhënave të kandidatëve aplikues si dhe shpalljen e fituesve. ishin prezente ne cdo rast qe u kerkua te shiheshin. |
| **Standardi III.2 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.** | |
| **Kriteri 1** Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;<br><br>**Kriteri 2** Institucioni disponon listën e plotë të personelit akademik për secilin semestër, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe atij administrativ;<br><br>**Kriteri 3** Institucioni publikon kriteret dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik;<br><br>**Kriteri 4** Institucioni angazhon si titullarë të lëndëve/moduleve për programet e studimeve të ciklit të parë, personel akademik që ka së paku gradën shkencore "Doktor,, ose titullin akademik "Docent,,. | Institucioni ka nje baze te mire te dhenash per anetaret e personelit akademik duke patur nje dosje personale per secilin. Eshte bere analiza e stafit akademik dhe perpunimi I ketyre te dhenave ne baze te indikatoreve te ndryshem si titujt akademike, botimet, pervoja, mosha etj. Institucioni ka listen e plote te stafit akademik, personelit administrative dhe atij ndihmes per cdo semester.<br>Kritetret dhe procedurat e punesimit jane te publikuara dhe te qarta.<br>Si titullare te studimit te ciklit te pare jane angazhuar staf me te pakten graden "doctor"ose docent me gjithe veshtirësite e rekrutimit te stafit me tituj te tille per shkak te mungeses se burimeve njerezore per kete program studimi ne Shqiperi.<br>Kontratat e punës në UAL janë hartuar në bazë të akteve ligjore ne fuqi dhe sipas tipologjise së pozicionit dhe vendit të punës. Dosjet e zgjedhura random kishin kontrata pune te rregullta. |
| **Standardi III.3 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.** | |
| **Kriteri 1** Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbatjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;<br><br>**Kriteri 2** Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë;<br><br>**Kriteri 3** Institucioni vë në dispozicion personel të mjaftueshëm për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve | UAL angazhon stafin akademik me kohë të plotë për të realizuar praktikat laboratorike të parashikuara në lëndë/modulet përkatëse. Pjesa me e madhe e ketij stafi duke qene dhe pedagoge te lendeve teorike realizojne ore laboratorike qe kane lidhje direkte me profesionin si dhe formimin akademik. U pa nje mirembajtje e mire e laboratoreve.<br>Praktikat spitalore të zhvilluara në insitucionet spitalore falë marrëveshjeve me UAL organizohen dhe mbikqyren në vazhdimësi nga referentët e praktikave që janë fizioterapistë të angazhuar në këto institucione.<br>Burimet njerezore jane angazhuar ne menyre optimale duke I perqasur ne lende e aktivitete qe kane lidhje direkte me formimin e tyre si staf akademik. |

| | |
|---|---|
| në praktikën profesionale (së paku 1 tutor/instruktor për 12 studentë). | Studentet referuan se ishin te kenaqur nga angazhimi i tyre ne keto institucione si dhe referuan perfshirje direkte praktike.<br>Për mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale angazhohet stafi me kohë të plotë i departamentit si dhe personeli fizioterapist i qëndrave shëndetësore ku zhvillohen praktikat spitalore (1 tutor për 3 -15 studentë) . |
| **Standardi III.4 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.** | |
| **Kriteri 1** Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor;<br><br>**Kriteri 2** Institucioni disponon një bazë të dhënash të programeve të studimeve të ofruara. | Vecori e UAL është se ai siguron kualifikimin e vazhdueshëm profesional të stafit të tij.<br>Këto aktivitete përfshijnë: shpërndarjen e informacioneve shkencore, mbështetjen për pjesëmarrje në konferenca e seminare kombëtare dhe rajonale, si dhe përfshirjen në studime konkrete.<br>Aktualisht ne programin e fizioterapise stafi akademik dhe studentet ishin te perfshire ne nje project kerkimor per skoliozen.<br>Gjithashtu për aktivitetet e edukimit në vazhdim, Universiteti "Aldent" organizon për stafin e tij konferenca, seminare, workshope dhe trajnime të ndryshme me pedagogë vendas dhe të huaj.<br>Ne dispozicion te GVJ u dhane dokumenta te mjaftueshme qe mbeshtesin keto aktivitete kryesisht financime per konferenca e trajnime brenda e jashte vendit. |

**Konkluzionet e vlerësimit:**

1. Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit të personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren; procesi I rekrutimit eshte transparente dhe ka indikatore te qarte per vleresimin e stafit te rekrutuar.
Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë përbën 71% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të pare.
Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për punë, apo dosje personale te stafit.
2. Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit si dhe ka nje hierarki te personelit. Institucioni disponon listën e plotë të personelit akademik për secilin semestër, të personelit ndihmës mësimor e shkencor dhe atij administrative,
3. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbatjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;duke patur si vecori angazhimin edhe ne praktika te personelit akademik te angazhuar ne leskione.
4. Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor; Institucioni disponon një bazë të dhënash të programeve të studimeve të ofruara.

**Standardet plotesohen**

## 4. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit

Fakulteti i Shkencave Mjeksore teknike ku ben pjese dhe programi i studimit bachelor ne fizioterapi e zhvillon aktivitetin akademik ne kampusin e universitetit ALDENT qe ndodhet prane Kasharit.

Mjediset mësimore janë të madhësive të ndryshme në përshtatje me natyrën e proçesit mësimor që zhvillohet në to. Kapaciteti i klasave është i madhësive të ndryshme.

Për Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike janë në dispozion rreth 5000 $m^2$, në të cilën përfshihen salla leksionesh dhe seminaresh, laboratorë të pajisur me të gjitha pajisjet e nevojshme, zyra për stafin dhe qeverinë studentore, bibliotekë, kafeteri si dhe një hapësirë e jashtme rreth 3500 $m^2$ për ambjente të tjera dhe parking.

Të gjitha sallat e leksioneve dhe seminareve u gjeten të pajisura me videoprojektor, kompjuter të lidhur me internet dhe tabela.

Në dispozicion të personelit akademik dhe administrativ ka ambiente të mjaftueshme e komode për punë dhe studimi individual të pajisura me të gjitha mjetet e nevojshme logjistike. Ambiente për bibliotekë, salla audiovizive, teknologjia etj.

Me qëllim lehtësimin e aksesimit të të dhënave personale personale të studentëve UAL ka portalin e studentit që u evidentua duke i kërkuar një studenti të futej dhe GVJ konstatoi se portali është funksional dhe shërben shumë mirë për studentët.

Gjatë vizitës në institucion u monitoruran laboratoret e Fizioterapisë dhe u gjet mjaft efektiv përdorimi i gjithë infrastrukturës në shërbim të programit të studimit.

Gjatë vizitës së GVJ në këtë Institucion vizitoi dhe konstatoi se:

***Auditorët mësimorë***- Të gjitha sallat e leksioneve dhe seminareve janë të pajisura me video-projektor, kompjuter të lidhur me internet dhe tabela. Klasat janë të mobiluara me karrige të bashkëlidhura me tavoleta.

***Ambientet për personelin pedagogjik dhe administrative***- Në dispozicion të personelit akademik dhe administrativ ka ambiente të mjaftueshme e komode për punë dhe studimi individual të pajisura me mjetet e nevojshme logjistike.

***Ambientet për bibliotekë, salla audiovizive, teknologjia etj***. - Për bibliotekën dhe teknologjinë janë vënë në dispozicion dy salla me kapacitet rreth 60 poste leximi (e verifikuar gjatë vizitës), 15 poste interneti të pajisura me kompjuter dhe biblioteka që kanë rreth 13500 tituj librash profesionalë. UAL ka një rrjet kompjuterik të shpërndarë në të gjithë godinën i cili u vjen në ndihmë stafit dhe studentëve.

Sallat e leksioneve dhe seminareve janë të pajisura me kompjutera dhe projektorë gjithashtu u jepet dhe akses në internet nëse është e nevojshme. Çdo zyrë është e paisur me kompjuter, akses në internet. I gjithë stafi i ALDENT ka adresën e brendëshme të email (.......@ual.edu.al) të cilën mund ta aksesojë si brenda dhe jashtë universitetit. Të gjithë studentet e ALDENT kanë adresat e brendëshme të email, të cilat mund ti aksesojnë nëpërmjet rrjetit ëireless në të gjithë godinën ose nga çdo vend tjetër rreth godinës UAL.

Bazuar ne dokumentacioni e vene ne dispozicion nga UAL dhe verifikimit gjate vizites ne vend Unersiteti Aldent është i abonuar prej disa vitesh në bibliotekën Hinari, bibliotekë e Organizatës Botërore të Shëndetësisë e cila shfrytëzohet aktivisht nga stafi dhe studentët.

***Sistemi i ngrohje-ftohjes*** - Objektet janë të pajisura me sistemin e ngrohje-ftohjes qendrore të konceptuara nga ndërtuesit që në projektim për kapacitet e shkollës.

***Nyjet hidrosanitare.*** - Shkolla disponon mbi 60 nyje hidrosanitare të kompletuara më së miri me standarde të larta higjieno –sanitare.
***Sistemi i mbrojtjes kundra zjarrit.*** - Godinat kanë të instaluar sistemin kundra zjarrit.
Ambientet mësimore ishin të pajisura të gjitha me kamera që monitorojnë 24 orë në 24 për të cilat Laboratorët në shërbim të studentëve që ndjekin programin e studimit Bsc në Fizioterapi janë:
***Laboratorët e Anatomisë dhe Fiziologjisë***- Atelie i pajisur me manikine dhe mulazhe të përshtatshme për t'u zhvilluar dhe kuptuar sa më mirë Anatomia humane dhe Fiziologjia si lëndë bazë të profesioneve mjekësore
***Laboratorët e Histologjisë dhe Anatomisë patologjike***- Kabinete të pajisura me mikroskopë dhe apartura të tjera të dedikuara për të zhvilluar lëndët e Histologjisë dhe Anatomisë patologjike. Pedagogët e kualifikuar u demostrojnë në preparate të parapërgatitura inde të ndryshme në mënyrë që studentët të arrijnë të diferencojnë dhe të kuptojnë karakteristikat e tyre në gjendje normale dhe patologjike.
***Laboratorët e Fizioterapisë***- Ishin 3 (tre) laboratorë kryesorë që shërbejnë për të kryer orët laboratorike të lëndëve rehabilutese si një domosdoshmëri për studentët e programit të Fizioterapisë të të gjitha viteve. Para se të fillojnë praktikat spitalore synohej që studentët të praktikojnë të gjitha metodat rehabilitues në manekinët e dedikuar për këto procese dhe ndaj njëri-tjetrit në grupe të vogla. Në këto atelie ishin te gjitha paisjet e nevojshme për procedura të rehabilitimit që kryhen në pacientët realë, të tilla si shtretër professional për manipulime fizioterapeutike, aparate me ultratinguj dhe infrared, ketler, bicikleta dhe pista vrapimi, step si dhe nje sërë mjetesh të tjera ndihmese per rehabilitim fizioterapeutik.
***Laboratoret e informatikës***- Gjatë vizitës në ambjentet e UAL pamë se ky laborator ishte i pajisur me 50 kompjutera në total të ndarë në tre klasa, të lidhur me internetin ku zhvillohet lënda e Informatikës gjatë së cilës studentët marrin njohuri efektive mbi përdorimin e programeve bazë kompjuterike. Të gjitha sallat e laboratoreve dhe leksioneve janë me ndriçim të mjaftueshëm natyral dhe artificial, me dritare me dopio xham si dhe me ajër të kondicionuar.

☑ Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion
- ➢ *Te dhena per laboratoret dhe pajisjet*

**Vlerësimi sipas Standardeve**

| Standardet/kriteret | Përmbushja e standardeve |
|---|---|
| **V - INSTITUCIONI OFRON SHËRBIME DHE VË NË DISPOZICION TË STUDENTËVE BIBLIOTEKA DHE BURIME TË TJERA INFORMACIONI** | |
| **Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.** | |
| **Kriteri 1** Institucioni vë në dispozicion të studentëve tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme në sasi dhe cilësore;<br>**Kriteri 2** Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për realizimin me sukses të programit të studimit;<br>**Kriteri 3** Në bibliotekë ka botime periodike dhe programe kompjuterike, si libraritë | Universiteti ka siguaruar leksione dhe tekste mësimore cilësore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore. Pjesa me e madhe e teksteve jane ne gjuhe te huaj kryesisht ne anglisht dhe italisht por leksionet dhe materialet e tjera ndihmese jane ne shqip. Aldent ka në dispozicion të studetëve rreth 13 mijë e pesëqind tituj të ndarë në dy biblioteka. Në bibliotekën e FSHMT ka literaturë të mjaftueshme me rreth 5 mijë libra që pasurohet në mënyrë periodike me botime (revista shkencore, |

| | |
|---|---|
| elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit;<br>**Kriteri 4** Përgjegjësit e programit hartojnë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për të;<br>**Kriteri 5** Biblioteka shpall oraret e shërbimit në përshtatje me oraret e programit të studimit dhe nevojat e studentëve. | libra, etj) . U kerkua ne menyre te rastesishme libra ne biblioteke sipas titujve te zgjedhur ne menyre rastesore dhe keto libra figuruan si fizikisht ashtu dhe te kataloguar.<br>Titujt në bibliotekë janë klasifikuar sipas profileve dhe disiplinave dhe informatizimi i saj është i pasuruar me informacion të gjerë mbi materialin në brendësi të librit. Gjithashtu është e disponueshme si për studentët dhe stafin akademik biblioteka online «Hinari» që ndikon në realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës se diplomës.<br>U verifikua tek nje student aksesi ne biblioteken on line "Hinari" dhe rezultoi ne rregull.<br>Ka nje plan per shtimin e titujve ne biblioteke si dhe u pa qe titujt e librave jane shtuar cdo vit sipas ketij plani.<br>Orari i shërbimit është në përshtatje me orarin mësimor dhe nevojave të studentëve duke qene pertej orarit te leksioneve dhe oreve ne auditor. |
| **Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë dhe mjedise të përshtatshme mësimore dhe për formimin praktik.** | |
| **Kriteri 1** Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit tëstudimeve;<br>**Kriteri 2** Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;<br>**Kriteri 3** Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve;<br>**Kriteri 4** Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator.<br>**Kriteri 5** Institucioni, në varësi të programeve të studimeve, disponon kompjutera në laboratorët e teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale si programe për statistikë, linguistikë, arkitekturë, inxhinieri, ekonomi, mjekësi, programestimulimi për shkencat sociale etj.<br>**Kriteri 6** Institucioni garanton, me | Aldent ka ne dispozicion nje sasi te mjaftueshme te klasave, zyrave dhe laboratoreve ne sherbim te realizimit te programit të studimit. Keto mjedise jane jo vetem ne dispozicion te programit te studimit por te universitetit ne pergjithsi, por duke qene se fizioterapia eshte program specific universiteti ka vene ne dispozicion edhe laboratore dhe klasa specifike per fizioterapine.<br>Keto paisje jane te pershtatshme dhe ne perputhje me qellimin dhe objektivat e programit.<br>Laboratoret permbajne te gjithe aparaturat e nevojshme si dhe mjete ndihmese specifike per kete program studimi duke permbushur me se miri nevojat e programit.<br>Në FSHMT janë në dispozicion të procesit mësimor 9 laboratore nga te cilat tre jane ekskluzive per fizioterapine. Të gjitha ambjentet kanë sistem kondicionimi. Sipërfaqja e vënë në shërbim të studentëve në programin e studimit Bsc ne Fizioterapi është optimale për zhvillimin e procesit të mësimdhënies si dhe zhvillimit te praktikave ne universitet.<br>Institucioni ka lidhur marrveshje bashkepunimin me institucione te tjera shteterore dhe private per |

| | |
|---|---|
| kapacitetet që zotëron ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme për zhvillimin e praktikave profesionale. | sigurimin/garantimin e praktikave. |
| **Konkluzione të GVJ:**<br>UAL ka një infrastrukturë mjaft të mirë në funksion të programit dhe plotëson të gjitha kriteret për një zhvillim optimal të procesit mësimor dhe në vecanti të lëndëve rehabilituese. Universiteti ka siguaruar leksione dhe tekste mësimore cilësore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore. Në bibliotekën e FSHMT ka literaturë të mjaftueshme me rreth 5 mijë libra që pasurohet në mënyrë periodike me botime (revista shkencore, libra, etj). Aldent ka ne dispozicion nje sasi te mjaftueshme te klasave, zyrave dhe laboratoreve ne sherbim te realizimit te programit të studimit.<br><br>**Standardet plotesohen** | |

## 5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

**Pjesa përshkrimore**

**Terma reference**: burimet e financimit, kostoja për student, kapacitetet menaxhuese.

Universiteti "Aldent" është një institucion privat i arsimit të lartë dhe duke qene I tille I gjithe burimi I finacimit eshte I brendshem. Burimi i financimit të UAL janë tarifat e studentëve.
Qëllimi kryesor i përdorimit të fondeve në këto vite ka qenë:

- Shtimi i infrastrukturës në dispozicion të studentëve si laboratore, auditore, biblioteka etj:

Vetëm në vitin 2014 sipërfaqja në dispozicion të studentëve ishte dyfishua nga $4m^2$ /student në $8m^2$ /student.

- Shtimi i numrit të stafit akademik dhe sidomos atyre me grada shkencore dhe që kanë përfunduar studimet jashtë vendit. Kjo nepermjet terheqjes se tyre jo vetem nga pagesa e mire por edhe per shkak te kushteve mjaft te mira te infrastruktures ku zhvillohet procesi mesimor.

- Shtimi i titujve të rinj në bibliotekë, abonimi në bibliotekën online, shtimi i numrit të PC, videoprojektorët, informatizimi, etj.

- Lehtësira për Studentët. Në UAL. Studentët ne UAL nuk paguajnë kosto shtesë përvec tarifës së shkollimit për: Ridhënien e provimeve, përsëritjen e vitit shkollor (për 1 vit) Për pajisjen me dokumentacion si vërtetime, transferime, çregjistrime, diplomime, etj. Për pagesa jashtë afatit të kontratës, për praktika mësimore dhe ekspedita jashtë Tiranës, transportin nga Qendra e Tiranës në Kampusin Qëndror, i cili është falas. Aktivitete kulturore dhe sportive që organizohen nga shkolla. Aktivitete shkencore si Summer School, Winter School, etj. Te gjitha keto aktivitete mbulohen nga pagesa per tarifen e shkolles.

- Financimi për veprimtari shkencore si për ato të organizuara nga UAL por edhe sponsorizimi i veprimtarive të organizuara nga institucionet e bashkëpunimit.

- Donacione me karakter humanitar si sponsorizim për rikonstruksionin e pavionit të Fizioterpaisë pranë QSUT, Rikonstruksion i çerdhes nr.23 në vartësi të Bashkisë së Tiranës, sponsorizime të përvitshme në infrastrukturën e QSUT si dhe donacionet e ndryshme në raste fatkeqësish natyrore, për fëmijët jetim, të moshuarit etj.

**Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

☑ Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në këtë program studimi
Tabelat me të ardhurat e UAL në vite i bashkëlidhen raportit

☑ Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik (në përqindje)
Shpenzimet e instiucionit të ndara sipas kategorive i bashkëlidhen raportin në tabela.

**Vlerësimi sipas Standardeve**

| Standardet/kriteret | Përmbushja e standardeve |
|---|---|
| **II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE**<br>**Standardi II.5 - Institucioni vlerëson dhe dokumeton gjendjen e tij financiare.** | |
| **Kriteri 1** Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm ose të brendshëm) të situatës financiare të tij;<br>**Kriteri 2** Në raportin e auditit paraqiten të gjitha detyrimet financiare, pagat e personelit, shpenzimet operative, etj;<br>**Kriteri 3** Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të parë. | Universiteti ALDENT ka nje sistem auditimi te brendshem te pervitshem te situates se tij financiare.U pa se ne te ishin te paraqitura te gjitha burimet e financimit, detyrimet financiare ku perfshiheshin qiraja e nderteses, pagat e personelit apo shpenzimet e tjera operative. Universiteti nuk ka grante te huaja te perftuara. |
| **VI - BURIMET FINANCIARE DHE VLERËSIMI FINANCIAR**<br>**Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.** | |
| **Kriteri 1** Institucioni harton një raport financiar që përmban një pasqyrë tëhollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare;<br>**Kriteri 2** Institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike;<br>**Kriteri 3** Institucioni dëshmon një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe | Universiteti ka nje raport te qarte financiar qe permban te dhena te hollesishme financiare per te ardhurat e instucionit, te ardhura keto qe jane ekskluzivisht nga tarifa e shkollimit te studenteve si dhe te dhena te hollesishme per shpenzimet dhe ndarjen e ketij burimi financimi.<br>Nje pjese e burimeve finaciare perdoren dukshem per te rritur kapacitetet e universitetit duke I investuar ne laboratore, paisje, mjete didaktike e libra etj<br>Ka raporte ta mbajtura jo vetem per tre vitet e kaluara akademike por per te gjithe vitet qe vleresohen ne kete akreditim pra per pese vitet e fundit.<br>Qendrueshmeria financiare e institucionit eshte e qarte dhe burimet financiare jane ne rritje. |

| | |
|---|---|
| gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen. | Kapacitetet financiare jane te qendrueshme dhe gjenerojne te ardhura te mjaftueshme per vazhdimesine e universitetit. |

**Konkluzionet e vlerësimit:**

Universiteti ALDENT ka nje burim te qarte e te qendrueshme financimi, kjo vjen teresisht nga tarifat e studenteve. Universiteti kishte një gjendje të qëndrueshme ekonomike në rritje të vazhdueshme nga viti në vit. Nuk rezulton te kete detyrime ndaj të tretëve qofshin këta individë apo organizata, banka apo ndaj organeve tatimore.

Ka nje rritje ekonomike ne vite dhe kjo i ka shërbyer rritjes së cilësisë në sajë të shtimit të laboratoreve, bazes materiale, infrastrukturës në shërbim të studentëve si dhe në financimin e stafit akademik në botime, pjesëmarrje dhe aktivitete të kërkimit shkencor. Universiteti ofron lehtësira financiare për studentët si: transporti falas, pagesë e ndarë në këste, dokumentacione dhe riprovime pa pagesë.
Gjithashtu UAL financon aktivitete të ndryshme per edukimin ne vazhdim sit e stafit ashtu te studenteve ne konferenca dhe aktivitete te nbdryshme.

**Standartet plotesohen**

## 6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

**Pjesa përshkrimore**

**Terma reference**: institucionalizimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, ngritja e Njësisë së SBC, funksionimi i saj, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.

U dëshmua gjatë vizitës se Njësia e Brendëshme e Sigurimit të Cilësisë (NJSBC) është një strukturë efektive e cila ka si qëllim vlerësimin dhe monitorimin e cilësisë së aktiviteteve të tij dhe komponentëve përbërës të tyre si: programeve mësimore, stafit akademik, administrativ dhe ndihmës, studentëve, mësimdhënies, shërbimeve të logjistikës dhe shërbimeve të tjera që ofron.

Përfaqësuiesit e kësaj njësie bënë një prezantim të shkurtër duke përmendur si funkionon kjo njësi, cilat janë detyrat e saj, si bëhej shperndarja e punëve brenda saj, etj.
Në Universitetin Aldent funksiononte Njësia e Brendëshme e Sigurimit të Cilësisë (NJSBC) prej disa vitesh. Kjo njësi kishte si qëllim vlerësimin dhe monitorimin e cilësisë së aktiviteteve të tij dhe komponentëve përbërës të tyre si: programeve mësimore, stafit akademik, administrativ dhe ndihmës, studentëve, mësimdhënies, shërbimeve të logjistikës dhe shërbimeve të tjera që ofron. Ekzistenca e kësaj strukturë është e paraqitur në Statut, Rregulloren e Brendshme të Universitetit Aldent, Rregulloren e NJSBC.
Gjatë takimit me këtë Njësi, na u komunikua se institucioni dokumenton proçeset e vlerësimit të performancës nëpërmjet disa kritereve që vlerësojnë arritjen nga pedagogu të objektivave të lëndës, përmbushjen cilësore të pritshmërisë së studentëve, angazhimine pedagogut për përmirësimin e vazhdueshëm të leksioneve,seminareve, praktikave të zhvilluara, veprimtarinë administrative dhe angazhimin e pedagogut në kërkimin shkencor, etj.
Në takimin me NJSBC u vu re një dokumentacion i plotë dhe seriozitet në funksionimin e kësaj strukure.

Stafi i NJSBC saj ka qene i qendrueshem pergjate viteve te fundit dhe reflekton programet e ndryshme qe universiteti ofron.

Aktivitetet e Përmirësimit të Vazhdueshëm janë listuar poshtë:

- Monitorimi i performancës së Indikatorëve
- Rishikimi periodik i Proçedurave/Proçeseve minimalisht 1 herë në 24 muaj.
- Rishikim të objektivave të cilësisë
- Trajnimet
- Aktivitetet e planifikuara të Ekipit të Cilësisë
- Rezultatet e auditimeve

Të dhënat statistikore analizohen dhe vlerësohen dhe me pas i komunikohen stafit për përmirësimin e performancës së tyre në punën e përditshme.
Matja e kënaqësisë së Studentëve eshte menyra kryesore me ane te se ciles njesia realizon monitorimin per nje sere indikatoresh te cilesise.
Pyetsori i studentëve behet perpara sezonit te provimeve ne menyre qe rezultatet e tyre te mos ndikojne studentet ne vleresimin e performances se pedagogeve apo indikatoreve te tjere te cilesise.
Pyetësorët plotësohen elektronikisht prej studentëve në mënyrë anonime.
NJSBC përbehej nga një anëtar për cdo njësi kryeore dhe detyrat e tyre përshkruheshin në rregulloren e funksionimit të kësaj strukture .

**<u>Vlerësimi i Treguesve të matshëm:</u>**

☑ Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC për programin e studimit, si:
Uniersiteti realizualizonte në mënyrë të vazhdueshme pyetesore per studentet, zakonisht në periudhën janar të çdo viti akademik para sezonit të provimeve të sesionit së shkurtit. Ne takime me NJSCB dhe nga dokumentacioni qe i istitucioni na vuri ne dispozicion rezulton se numri i studentëve të anketuar ka ardhur në rritje.
Pyetsori I anketimeve eshte përmirsuar duke shtuar vazhdimisht indikatore qe sherbejne jo vetem per vleresimin e procesit mesimor por edhe per mbarevajtjen e jetes studentore dhe te universitetit ne pergjithësi. Anketimet jane anonime ne menyre qe studentet te shprehin lirshem mendimet e vleresimet e tyre por edhe shqetesimet.

**Anketimet dhe masat e marra**
Numri i studentëve të anketuar ka ardhur në rritje.
NJSBC pas cdo anketim ben raportim ne Fakultetet përkatëse, problemet lidhur me rezultatet e pyetësorëve etj. Pedagogët janë vënë në dijeni të ankesave të studentëve që të marin masa në drejtim të komunikimit profesional dhe etik, si dhe përpërmirësimin e cilësisë së zhvillimit të mësimit për të rritur interesin e formimin e studentëve. Nëpërmjet strukturës së tutoriatit akademik synohej për ndërgjegjësimin e orientimin e studentëve për përpjekjet që ata duhet të bëjnë për formimin e tyre nga programi i zgjedhur. Gjithashtu është kërkuar sensibilizimi i studentëve mbi rëndësinë e të mësuarit rregullisht dhe ofrimi i orientimit të studentëve në drejtim të përshtatjes me efikasitet drejt programit të zgjedhur nëpërmjet strukturës së tutoriatit akademik

**Vlerësimi sipas Standardeve**

| Standardet/kriteret | Përmbushja e standardeve |
|---|---|
| **II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE** **Standardi II.3 - Institucioni, për akreditimin e programeve të studimeve, përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e tyre.** | |
| **Kriteri 1** Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;<br>**Kriteri 2** Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional;<br>**Kriteri 3** Institucioni publikon rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;<br>**Kriteri 4** Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta:<br><br>Të tërthorta:<br>a. Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve;<br>b. Sondazhe të vlerësimit të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit;<br>c. Pyetje konceptuale;<br>d. Intervista;<br>e. Etj.<br><br>Të drejtpërdrejta:<br><br>a. Teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara);<br>b. Dëgjime në auditor;<br>c. Vlerësimi me nota/pikë;<br>d. Testime paraprake dhe përfundimtare; provime për module, praktikë;<br>e. Vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët (detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, provimet, referatet);<br>f. Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;<br>g. Etj. | Universiteti ka ne perberje te struktures se tij Njesine e Brendshme te Sigurimit te Cilesise, njesi kjo qe ka vite qe funksionon. Universiteti ka nje metodologji te qarte vleresimi dhe instrumenta matese per ecurine e programeve te studimit. Ky informacion perfshihet ne vetevleresimin e universitetit. Jane publikuar e analizuar rezultatet nga metodologjia e perdorur per te vleresuar cilesine. Perdoren gati te gjitha metodat si te drejtperdrejta ashtu dhe ato te terthorta per matjen e cilesise por kryesisht metoda me e perdorur eshte nepermjet pyetsoreve qe plotesohen nga studentet.<br>Forme tjeter e perdorur gjeresisht eshte ajo nepermjet sistemit të Tutorëve/Kujdestarëve të grupeve të studentëve të cilët mundësojnë në mënyrë permanente intervistimin e tyre për të gjitha aspektet e proçesit arsimor dhe i dokumetojnë ato në hapësirën e dedikuar për pedagogun kujdestar në platformën elektronike si dhe në raportimin mujor në dekanat.<br>Vlerësimi i studentëve bëhet sipas formave të përcaktuara të cilat janë pjesë e Statutit, Rregullores së përgjithshme dhe dokumetave të tjerë rregullatorë që shprehen të detajuara në syllabusin e çdo lënde.<br>Të gjitha pikët e mbledhura në komponentët përbërës të lëndës pasqyrohen në proçesverbalet të cilat janë në përputhje me legjislacionin dhe aktet rregullatore.<br>Testimet, Seminaret, Detyrat e Kursit, Projektet, etj janë pjesë e vlerësimit të vazhdueshëm të studentëve në varësi të disiplinës së lëndës .<br>Pjese e vleresimit per programin e studimit bachelor ne fizioterapi eshte dhe vleresimi gjate parktikave qe bejne studentet gjate aplikimit te procedurave fizioterapeutike. |
| **VIII - INSTITUCIONI GARANTON SIGURIMIN E CILËSISË** **Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.** | |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 1** Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;<br>**Kriteri 2** Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;<br>**Kriteri 3** Institucioni harton një politikë të qartë dhe ndjek procedurën e vlerësimit periodik të efikasitetit të veprimtarive që kryen për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të studimeve që ofron;<br>**Kriteri 4** Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve që ofron;<br>**Kriteri 5** Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;<br>**Kriteri 6** Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar. | Universiteti Aldent ka plotësur standartët institucionale dhe është i akredituar në nivel institucional.<br>Universiteti perdor si instrument te sigurimit te cilesise Njesine e brendshme te Sigurimit te Cilesise e cila perdor metoda sit e drejtperdrejta ashtu dhe te terthorta per vleresimin e cilesise dhe sigurisht sigurimin e saj. Keto metoda jane permirsuar me kalimin e viteve.<br>UAL në bashkëpunim me NJSBC harton, zbaton dhe publikon strategjitë që lidhen me përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë.<br>Efikasiteti I mesimdhenies por edhe realizimi I objektiva te tjera vleresohet ne menyre periodike ne menyre qe te arrihen standartet e kerkuara.<br>Metodat e perdorura jane te formalizuara dhe te dokumentuara mire.<br>Behet nje pune e mire per ndergjegjesimin e punonjesve dhe studenteve per rendesine e procesit te vleresimit te cilesise dhe perpilimin nga ana e tyre te formulareve te vleresimit me perpikmeri dhe seriozitet.<br>NJSBC ka përcaktuar standarte cilësie të brendëshme dhe organizon audit të brendshëm të të gjitha njësive kryesore dhe ndihmëse gjatë çdo viti akademik për të verifikuar plotësimin e këtyre standarteve.<br>Ka nje strategji te qarte per permirsimin e vazhdueshme te cilesise. |

**Konkluzionet e vlerësimit:**

Universiteti ka nje metodologji te qarte te vleresimit te cilesise dhe ecurise se programeve te studimeve. Kjo realizohet nepermjet Njesise se Brendshme te Sigurimit te Cilesise. Ky informacion i marre nga kjo njesi perfshihet ne vetevleresimin institucional te universitetit. Per kete universiteti perdor metoda te drejtperdrejta ose te terthorta por me e perdorura eshte ajo nepermjet pyetsoreve te plotesuar nga studentet.

Çdo anëtar i grupit të NJSBC përfaqëson njësinë mësimore apo administrative që i përket dhe merr informacionin bazë të auditimit të kësaj strukture. Të gjitha problematikat dhe rezulatet diskutohen në mbledhjet periodike të grupit dhe merren masa konkrete të menjëhershme në drejtim të ruajtjes së një niveli të lartë cilësise.

Efikasiteti i mesimdhenies por edhe realizimi i objektiva te tjera vleresohet ne menyre periodike ne menyre qe te arrihen standartet e kerkuara.
Metodat e perdorura jane te formalizuara dhe te dokumentuara mire.
Ka nje strategji te qarte dhe te vazhdueshme per permirsimin e cilesise.
**Standartet plotesohen**

## POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

### 7. Programi i studimit, organizimi i tij
**Pjesa përshkrimore**

> **Terma reference**: misioni dhe objektivi i programit të studimit, përmbajtja e programit, organizimi i vitit mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies), literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse, etj

Programi i studimit Bsc në "Fizioterapi" është licensuar me vendim të Këshillit të Ministrave Nr.370 datë 27.07.2011 dhe synon:

- Formimin e specialistëve me njohuri të nevojshme shkencore, vlera etike dhe morale në aplikimin e profesionit të Fizioterapistit.
- Përgatitjen e profesionistëve në fizioterapi, me njohuri e kompetenca të nevojshme fizioterapeutike teorike dhe praktike, të aftë të punojnë në sektorin e rehabilitimit në përputhje me normat e paracaktuara nga Komuniteti Europian.
- Formimin e profesionistëve të aftë të njohin fenomenet thelbësore biologjike, hereditare, dhe fizpatologjike si dhe ndërthurjen e psikologjisë së individit dhe realitetit socio- ambiental.
- Aftësimin e studentëve për t"u përfshirë në aktivitete konkrete mjekësore dhe për tu angazhuar në funksione të ndryshme në sektorin publik apo privat.

**Misioni**

Bazuar ne dokumentacioni e paraqitur nga Institucioni dhe nga takimet e realizuara me tuitullaret e UAL, ky program studimi ka si mision:

- Dhënien e njohurive teorike dhe praktike në shkencat themelore biomjekësore, shkencat humane dhe ato profesionale klinike të fizioterapisë, për përvetësimin e dijeve profesionale fizioterapeutike.
- Fitimin e aftësive të duhura për kryerjen e aktiviteteve në mënyrë autonome nëpërmjet ndërhyrjeve për parandalim, kurim dhe rehabilitim të zonave motore, funksioneve kortikale superiore dhe viscerale me pasoja nga patologji të ndryshme të lindura dhe të fituara.

Disiplinat mësimore dhe veprimatritë e tjera formuese që ofrohen në këtë program studimi janë të organizuara në 6 kategori, nga A – F në zbatim të akteve nënligjore që përshkruajnë organizimin e programit.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe takimet me titullaret /stafin e programit konstatuam se, disiplinat mësimore dhe veprimtaritë formuese që ofrohen në këtë program dhe kreditet për secilën prej tyre rishikohen në mënyrë periodike.

Ne takimet e realizuara na u konfirmua se ndryshimet propozohen nga njësia bazë përgjegjëse dhe miratohen nga Këshilli i Fakultetit, duke marrë në konsideratë kërkesat në rritje të tregut të punës.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe takimet e realizuar ne UAL konfirmuan se praktikat profesionale organizohen nga Departamenti dhe mbikqyren nga pedagogët e lëndëve profesionale në bashkëpunim me personelin e qendrave shëndetësore. Gjatë praktikës, studentët ndjekin pacientë të caktuar për të referuar më pas tema të marra nga rastet e studiuara.

☑ Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)

Veprimtaria mësimore është organizuar sipas sistemit me 2 semestra. Edhe pse kemi te bejme me nje program studimi Bachelor, gjate takimeve me stafin dhe studente na u tha se, studentët nxiten të kryejnë kërkim individual gjatë zhvillimit të lëndëve nëpërmjet detyrave kursi me tema profesionale të ndryshme si dhe për pjesëmarrje të përvitshme në Konferencën shkencore studentore.

- 1 vit akademik ka 30 javë mësimore në auditor;
- 1 Semestër ka 15 javë mësimore në audito;
- 1 ECTS 25 orë mësimore punë të studentit;
- 1 orë mësimore 60 minuta.

Në program janë parashikuar lëndët dhe kreditet përkatëse, po ashtu dhe organizimi i tyre në orë mësimore dhe studim individual. Shpërndarja e krediteve është bërë referuar udhëzimeve dhe rregullave, të vendosura nga Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë. Ne takimet me titullaret dhe studentet na u tha se departamenti organizohen edhe aktivitete të tutoriatit për tju ardhur ne ndihme studentevene lidhe me problematika te ndyshme qe ata mund te hasin. Ne keto veprimtari perfshihej i gjithe departamenti. Per keto aktivitete UAL kishte vene nje hapsire te caktuar ne platformen e tij elekronike, ku pasqyroheshin pasqyron frekuentimin dhe ecurinë e studentëve që ka nën tutorim.
Ky program studimi ofrohet vetëm me kohë të plotë. Secila disiplinë ka lëndën apo grup lëndësh përkatëse, të cilat janë të shprehura në orë mësimore dhe kredite.

Ndarja e aktiviteteve didaktike është kryer sipas udhëzimeve të MASH dhe paraqitet në tabelën e mëposhtme :

| Ndarja e aktiviteteve didaktike | | |
|---|---|---|
| **Aktiviteti didaktik** | Orë në auditor/ etsc | Orë studimi individual/ etsc |
| **Leksione (l)** | 6 - 12 | 9 - 13 |
| **Laboratorë(lab)** | 18 - 25 | 0 - 7 |
| **Praktika (p)** | 20 - 25 | 0 - 5 |
| **Diploma** | 2 | 23 |

Nga analizimi i planit mesimore verejme se ne te jane bere ndyshime te cilat nuk e kalojne 20% e lejuar nga ligji. Keto ndyshime ishin bere ne kauder te permiresimit te programit te studimit dhe me qellim pershtajen e programit Bsc ne Fizioterapi ne perputhje me kerkesat ligjore ne fuqi.
Per realizimin e ketyre ndyshimeve ishte ndjekur nje procedure e rregullt e cila na u vu ne dispozicion nga Institucioni gjate vizites.

Institucioni ishte kujdesur që për cdo modul/lende të sillet në auditor specialist i fushës përkatëse duke siguruar keshtu cilesi ne mesimdhenie dhe ne transmetimin e Informacionit tek studentet.
Sikurse na u konfirmua nga departamenti dhe pedagogët gjatë takimeve me ta, në fillim të çdo viti akademik përgatitet nga pedagogët e përzgjedhur syllabusi i lëndës/modulit, përmbajtja e të cilit mbështetet në standartet kombëtare të cilësisë për arsimin e lartë dhe përmban të gjithë elementët e nevojshëm të aprovuar nga senati akademik.
Syllabusi i lëndës me të gjithë elementët e përmbajtjes së tij i bashkëlidhej RVB dhe gjithë dosja u evidentua na u vu në dispozicion nga institucioni.

Institucioni vuri në dispozicion të grupit gjithë syllabuset e lëndëve/moduleve të cilat u gjetën korrekte dhe me të gjithë elementët e aprovuar nga MASR.

**Vlerësimi sipas Standardeve**

| **Standardet/kriteret** | **Përmbushja e standardeve** |
|---|---|
| **I - PROGRAMET E STUDIMEVE TË OFRUARA** <br> **Standardi I. 1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.** | |
| **Kriteri 1** Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);<br><br>**Kriteri 2** Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite; | Universiteti Aldent ka licencuar Programi Bachelor në Fizioterapi me urdhër Nr.370, datë 27.07.2011, program ky qe është akredituar me urdhër Nr. 326, datë 27.08.2012, për "Akreditimin e programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në "Fizioterapi".<br>Programi i studimit eshte i organizuar e ndare ne module ku secili prej tyre vleresohet me kredite sipas Sistemit Europian te Transferimit dhe Grumbullimit te krediteve.<br>Per cdo student sasia mesatare e krediteve te grumbulluara gjate nje viti akademik eshte 60 kredite dhe programi i studimit eshte me kohe te plote.<br>Programi zbaton aktet ligjore e nënligjore në fuqi mbi organizimin e programeve për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërsisë. |
| **II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE** <br> **Standardi II.4 - Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara dhe informuese.** | |
| **Kriteri 1** Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për përmbajtjen e programeve të studimeve;<br><br>**Kriteri 2** Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për lëndët me zgjedhje apo të detyruara për semestër; | Universiteti e ne vecanti per kete program Fakulteti i Shkencave Mjekesore Teknike jep te gjitha informacionet e nevojshme per permbajtjen e programeve te studimeve per cdo individ qe eshte i interesuar. Kjo mund te behet on line ne faqen e universitetit ose prane sekretarise se tij.<br>Cdo student u pa qe informohej ne fillim te vitit per lendet qe duhet te ndjeke cdo semester e detyrimet qe duhet te permbushe. |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 3** Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ ndjekjen e programit;<br><br>**Kriteri 4** Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për syllabuset e detajuara për secilën lëndë, për praktikat, ushtrimet apo orët e laboratorit, etj. | Çdo pedagog përpilon syllabusin e lëndës/ modulit çdo fillim viti akademik sipas formatit të shpërndarë në formë elektronike nga Dega mësimore dhe që përmban të gjithë elementët e detajuar të zhvillimit të procesit mësimor.<br>Informacioni jepej i detajuar per cdo lende per ngarkesen mesimore, oret ne auditor, frekuentimin dhe ndjekjen e programit, detyrimet e praktikave etj.<br>Para fillimit të lëndës/modulit cdo pedagog ju paraqet studentëve syllabusin e lëndës së bashku me modalitet e përfshira në të për zhvillimin e mësimit. |

**Konkluzionet e vlerësimit:**

Programi i studimit bachelor ne Fizioterapi eshte ndertuar ne menyre te tille qe studenti te fitoje njohurite dhe aftesite e nevojshme per te punuar si profesionist i mirefillte ne fushen e fizioterapise. Ai pergatitet per te qene nje profesionit i kohes ne menyre qe te ndertoje nje karriere te arrire dhe te jete i afte te punoje ne nje mjedis te ndryshueshem.

Ne perfundim te programit nga kqyrja e syllabuseve u pa se studenti do te fitoje njohuri kyce per rehabilitimin neurologjik e me gjere, performancen dhe funksionin e levizjeve, raste te thjeshta e te nderluikuara ne praktike te manaxhimit fizioterapeutik, manaxhimin e semundjeve kronike por edhe etiken dhe metodat e kerkimit shkencor etj.

Shpërndarja e disiplinave në vite studimi është realizuar në mënyrë kronologjike, duke filluar me formimin bazë, i cili përfshin njohjen e studentëve me nocionet kryesore të anatomisë dhe të fiziologjisë humane e deri në konkretizimin profesional dhe praktik të profesionit të Fizioterapistit.

Programi i studimit eshte i organizuar e ndare ne module ku secili prej tyre vleresohet me kredite sipas Sistemit Europian te Transferimit dhe Grumbullimit te krediteve.

**Standartet plotesohen**

## 8. Mësimdhënia

**Pjesa përshkrimore**

Nderkohe qe mjedisi i profesionisteve ne fushen e shendetesise vazhdon te ndryshoje, ka nje trysni ne rritje per programet e edukimit e formimit ne fushen e fizioterapise ne menyre qe te diplomojne profesioniste qe jane te afte dhe te pergatiutur per mjedisin gjithnje ne ndryshim ne kete fushe. Gjeja e pare per te cilin duhen te ndergjegjesohen pedagoget qe pregatisin kurrikulat ne kete fushe eshte ti bejne te afte studentet te reagojne si duhet ne nje mjedis gjithnje te ndryshuueshem dhe sidomos per situata klinike komplekse. Përqasja duhet te jete holistike.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe nga takimet qe realizuan ne vend konstatuam qe teknikat e mësimdhënies qe perdorte UAL ishin bashkëkohore dhe kishin për qëllim nxitjen e studentit për të qënë pjesë aktive e procesit nëpërmjet përdorimit të metodave interaktive. Per realizimin sa me te mire dhe efikas te mesimdhenies institucioni disa metoda duke filluar nga ato me tradicionalet

deri tek perdori i teknologjive te reja te informacionit, gjithashtu ne mbeshtje te nje mesimdhenie te tille vihen ne dispozicion mjedise te mjafrueshme, auditore dhe laboratore.

Ajo qe vihet re ne kete program studimi dhe vlen ta thejksojme është ndërthurja e shpjegimit teorik të metodave specifike rehabilituese dhe aplikimi i tyre konkret në kabinetet e fizioterapisë, qe eshte shumë e rëndësishme në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies për studentët e fizioterapisë. Kjo gje realizohet me sukses ne pjesen me te madhe te rasteve. Kjo mënyrë nuk përshkruhej thjesht në dokumentacion por zbatohej në auditore gjë që konsiderohej element shume i rendesishem qe studentët kishin gjetur si arsye për vazhdimin e studimeve të tyre në ALDENT. (Kjo na u konfirmua ne takimin qe realizuam me studentet.

Ajo cka ne vume re eshte komunikimi i pedagogëve lëndës me studentët për mënyrën e shpërndarjes së materialeve didaktike. Gjate takimeve qe realizuam dhe me pas nga demostrimi qe na u be ne UAL, pam se ne dispozicion të procesit akademik është vënë një hapësirë virtuale (google clasroom) të cilën pedagogët e bëjnë aktive me titullin e lëndës dhe publikojnë vetëm për studentët e grupit të tyre materiale didaktike si përmbledhje të leksioneve në Ppt, linke, foto dhe video mësimore, afatet dhe detyrimet e studentit për këtë lëndë/modul. Kjo mënyrë u vlerësua si nga ana e stafit ashtu edhe studentëve gjatë takimeve që GVJ pati me ta

Institucioni kishte lidhur disa marreveshje bashkepunimi me institucione publike dhe private te cilat sherbenin per realizimin e praktikat profesionale të studentëve. Ndër to përmendim Qendrën spitalore Universitare "Nënë Tereza", Spitalin Universitar të Traumës, "Shtëpia e Zotërinjve", Kolegjin "HEIMERER" etj.
Këto praktika ndiqen dhe mbikqyren nga departamenti dhe referentët e paracaktuar.
Ne perfundi te ciklit te pare te studime ne programin Bsc ne Fizioterapi studentet bënin nje provim formimi.

Ajo qe konstatuam nga dokumentacioni dhe takimet e realizuara me stafin dhe studentet ishte se, kontrolli i njohurive dhe format e kontrollit- Forma e kontrollit të dijes bëhet përmes sistemit te vlerësimit me elementë të shumëfishtë. Vleresimi qe perdorej ishte sistemi shqiptar i vlerësimit me 10 nota (nga 1 tek 10, ku 10 është vlerësimi maksimal). Shkalla e përvetësimit të dijeve me shkrim dhe/ose me zë bëhet me pikë nga 0-100 pikë dhe rezultati përfundimtar konvertohet në notë nga 4 (katër) në 10 (dhjetë) sipas tabelës së mëposhtme:

| Pikët | 0-40 | 41-50 | 51-60 | 61-70 | 71- 80 | 81-90 | 91-100 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Notat | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 |

Në vlerësimin përfundimtar të studentit në një disiplinë të caktuar merreshin në konsideratë të disa elementet përbërëse të lëndës si: pjesa teorike, pjesa e seminareve, projektet, kontrollet e pjesshme, etj.

Rezulton se mënyra e vlerësimit me elementë të shumëfishtë garanton kontrollin më të mirë nga ana e pedagogëve dhe në të njëjtën kohë nxit studentët për përgatitje më sistematike gjatë gjithë semestrit duke motivuar vëmendjen e tyre në të gjithë elementët e vlerësimit.

Në format e kontrollit, me shkrim, përdoret sistemi i vlerësimit me pike. Tezat e provimit, në të gjitha rastet e kontrollit, hartohen nga titullari i lëndës dhe miratohen e nënshkruhen nga

përgjegjësi i departamentit. pajiset nga sekretaria me bar-kod individual për çdo student dhe çkodohet pas korigjimit nga pedagogu.

Nga verikimi qe GVJ i beri syllabuseve vume re qe ne to përcaktohet edhe përqindja (pikëzimi) që zënë në vlerësimin total elemetët e tjerë të kontrollit të dijeve si pjesëmarrja, detyrat, laboratoret, testimet gjatë vitit etj e cila aprovohet nga dekanati dhe varet nga natyra e disiplinës dhe ngarkesës në auditor.

Diplomimi- Për programin e Bsc ne Fizioterapisë ishte e parashikuar provimin me shkrim dhe me gojë para komisionit të aprovuar paraprakisht cili nuk bëhet i ditur për studentët deri në ditën e provimit. Pas përfundimin me sukses të ciklit të studimit dhe mbrojtjes së diplomës, studenti pajiset me diplomë universitare.

GVJ pa se forma dhe përmbajta e dokumentit të diplomës i përmbahet udhëzimit Nr.5, datë 18.02.2009 "Për përmbajtjen dhe formën e diplomës së lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë" i ndryshuar, dhe është regjistruar në regjistrin kombëtar të çertifikatave dhe diplomave me një numër unik konform udhëzimit Nr12, datë 18.03.2009 "Për krijimin e regjistrit shtetëror të diplomave dhe çertifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor". Diploma shoqerohet me suplementin e saj, e cila ishte konform udhezimeve te ministrise.

☑ Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Syllabuset e lëndëve ku ishte përshkruar e detajuar organizimi dhe mënyrat e mësimdhënies, plani mësimor i detajuar me ngarkesën e orëve për cdo komponent të mësimdhënies si dhe mënyra e vlerësimit të njohurive si dhe u këkua nga sekteraria mësimore fletaprovimi ku u evidentua e zbatuar e gjithë procedura e përmendur.

## 9. Studentët

**Pjesa përshkrimore**

Kuotat e pranimit të studentëve në të gjitha programet e studimit miratohen nga Senati Akademik bazuar në planin e zhvillimit të institucionit.

Përcaktimi i kuotave të pranimit mbështetet në standardet e miratuara të dhe në përputhje me: Kapacitetet njerëzore dhe logjistike dhe planin e zhvillimit të tyre; standardet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për infrastrukturën, stafin akademik efektiv apo raportin pedagog/student.

Ajo qe konstatuam ishte se aplikimet e maturantëve për Universitetin "ALDENT" kryhen nëpëmjet portalit të maturës shtetërore, procedura e përzgjedhjes dhe regjistrimit është transparente në zbatim të kritereve të përcaktuara dhe udhëzimeve të përvitshme të MASR për këtë proces.

UAL e konsideron dhe kujdeset per Studentët per ti angazhuar ata në veprimtari të ndryshme ekstrakurrikulare. UAL dhe strukturat e saj synojnë që studentët të ndjehen pjesë aktive e komunitetit ku bëjnë pjesë, duke u angazhuar në aktivitete kulturore, artistike, dhe sportive. Senati Studentor përgjigjet për nisma, vendime, dhe marrëveshje në lidhje me jetën dhe veprimtaritë studentore dhe kanë të drejtën të organizojnë veprimtari të ndryshme si: pjesëmarrja

në klube studentore, ekskursione, udhëtime, dhe mbledhje shoqërore, gjatë vitit akademik. Universiteti "Aldent" organizon kampionatin e përvitshëm të futbollit nëpërmjet programeve dhe grupeve të ndryshme studentore

Studentët janë të përfaqësuar nga Senati studentor që përgjigjet për nisma, vendime, dhe marrëveshje në lidhje me jetën dhe veprimtaritë studentore dhe kanë të drejtën të organizojnë veprimtari të ndryshme, duke përfshirë ekskursione, udhëtime, dhe mbledhje shoqërore, të cilat realizohen gjatë vitit akademik. Gjithashtu studentët e UAL të shoqëruar ng pedagogët kanë marrë pjesë aktive në shkolla verore dhe dimërore të investuara nga institucioni.

**Zyra e Karrieres**: Nga dokumentacioni qe Universiteti "ALDENT" na vuri ne dispozicion dhe takimi qe realizuam ne kete zyre konstatuam se qellimi kryesor i Zyres se Karrieres eshte qe t"u vije ne ndihme te gjithe studenteve qe vazhdojne dhe qe kane perfunduar studimet ne "ALDENT". Kjo zyre ofronte asistence per studentet duke filluar nga gjerat me te thjeshta si plotesimi i nje CV deri ne menyren sesi duhet aplikuar per nje vend pune qofte ne sektorin publik apo ate privat.

| **Periudha e të dhënave 2012-2017 nga burime të tërthorta për punësimin** | | | |
|---|---|---|---|
| **Programi i studimit**<br>BSc në. FIZIOTERAPI | **Numri total të diplomuarve** | **Numri total i të punësuarve (në përputhje me diplomën)** | **Numri total i të punësuarve (jo në përputhje me diplomën)** |
| | 159 | 80 | 42 |

**Vlerësimi i Tregues të matshëm:**

☑ Procedurat e pranimit të studentëve

Per te vazhduar studimet ne kete program studimi aplikimi i maturanteve kryhej nepemjet portalit te matures shteterore, procedura e perzgjedhjes dhe regjistrimit eshte transparente ne zbatim te kritereve te percaktuara dhe udhezimeve te pervitshme te MASR per kete proces. Per vitin aktual, ne zbatim te udhezimit Nr.15 date19.05.2017 "Per procedurat e aplikimit dhete regjistrimit per programet e ciklit te pare te studimeve, ne programet e studimeve me karakter profesional, si dhe ne programet e integruara te ciklit te dyte, ne institucionet e arsimit te larte per vitin akademik 2017-2018".

| Kriteret e pranimit Bachelor në FIZIOTERAPI për 2017-2018 |
|---|
| 60% mesatare e shkollës së mesme dhe 40% gruplëndët preferenciale ( Kimi 10%, Biologji 10%, Gjuhë e huaj e parë 10%, TIK 5%, Qytetari 5 %). |

☑ Cilësia në hyrje e studentëve

Vendosja e kriterit të notës mesatare si dhe llogaritja e notës së lëndëve preferenaciale për këtë program ka bërë që nota në hyrje e studentëve të vijë duke u rritur.

| Vitet | 2012-13 | 2013-14 | 2014-15 | 2015-16 | 2016-17 | 2017-18 |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Nota mestare në hyrje** | **6.1** | **6.78** | **6.28** | **6.91** | **7.68** | **7.34** |

☑ Studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë). Nota Mesatare

| Periudha/Viti i studimit | Studentë të regjistruar në vitin e parë | Nota mesatare |
|---|---|---|
| 2012-2013 | 48 | 6.1 |
| 2013-2014 | 48 | 6.78 |
| 2014-2015 | 23 | 6.28 |
| 2015-2016 | 102 | 6.91 |
| 2016-2017 | 60 | 7.68 |
| 2017-2018 | 60 | 7.34 |

☑ Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend

**Transferimet-** Tranferimi i studenteve behej bazuar ne legjislacionin ne fuqi dhe ne perputhje me rregullat e vendosura kuadrin rregullator te brendshem, institucioni ka pranuar regjistrimin e studenteve te transferuar nga institucione te tjera, duke bere te mundur njohjen e krediteve perkatese. Ne baze te Rregullores se Brendshme dhe rregulloreve perkatese te programeve, ngrihet komisioni per njohjen dhe transferimet e krediteve. Per njohjen e lendeve/krediteve ngrihej nje komision i posacem cili pasi vleresonte programet e paraqitura, perpilonte nje raport te detajuar me lendet apo modulet kreditet e te cilave mund transferohen.

| **Sipas Viteve** | **Studente te transferuar** |
|---|---|
| 2012-2013 | 6 |
| 2013-2014 | 6 |
| 2014-2015 | 10 |
| 2015-2016 | 3 |
| 2016-2017 | 1 |
| 2017-2018 | 1 |

☑ Të dhëna për punësimin e studentëve

Ne takimin qe patem me zyra e karrieres, na u tha se kjo zyre mbare mban kontakte te vazhdueshme me studentet e diplomuar per ndjekjen e karrieres se tyre profesionale si dhe per t'i njoftuar me mundesi punesimi dhe aktivitete te edukimit ne vazhdim qe organizohen nga ALDENT.

Zyra e karrieres organizonte aktivitete te ndyshme ku ishin te ftuar te merrnin pjese te gjithe studentet. Nje aktivitet qe ishte organizuar ishte prezantimi i projektit “Work&Travel USA 2017” qe kishte te bente me punësimin e studentëve gjatë sezonit veror në SHBA.

